



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË

Nr. prot.

7009/2

Tiranë, më 22.11.2017

**FTESË PËR KONKURRIM**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, në zbatim të nenit 12 të Ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Ministrisë së Drejtësisë” (i ndryshuar me Ligjin nr. 9112, datë 24.7.2003 dhe ndryshuar me nenin 10 të Ligjit nr. 9694, datë 19.3.2007), Urdhrit të Kryeministrit, nr. 188 datë 18.10.2013 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Drejtësisë”, Udhëzimit Nr. 3165, date 12.05.2004, “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, dhe tarifave të shpërblimit të përkthyesve të jashtëm, si dhe tarifave të përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretët” (i ndryshuar) dhe Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”,

**MINISTRIA E DREJTËSISË SHPALL TË HAPUR KONKURSION PËR  
PËRKTHYES ZYRTAR**

**Janë të ftuar të aplikojnë të gjithë personat që plotësojnë kriteret e mëposhtme nga të gjitha rrethet e Shqipërisë.**

**I. Kriteret e Përgjithshme:**

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të ketë mbaruar arsimin e lartë;
- d) Të ketë eksperiencë pune prej jo më pak se tre vjet në përkthim ose në mësimdhënien e gjuhës;
- e) Të mos ketë qenë dënuar apo të mos jetë në ndjekje penale;
- i) Të zotërojnë shumë mirë programet bazë të kompjuterit.

**II. Kriteret e Veçanta:**

- a- Të njohë shumë mirë gjuhën në të cilën kërkon të përkthejë;
- b- Kanë përparësi:
  - (i) personat që kanë ndjekur studimet universitare për gjuhën përkatëse ose për drejtësi në një nga universitetet, gjuha e të cilit është ajo për të cilën aplikon;
  - (ii) personat që kanë ndjekur studime të thelluara të fushës në fjalë;
  - (iii) personat që e kanë gjuhë amtare gjuhën në të cilën kërkojnë të përkthejnë;
  - (iv) të diplomuarit apo të specializuarit jashtë vendit;
  - (v) personat që kanë dhënë provimin përkatës të gjuhës në të cilën kërkojnë të përkthejnë brenda apo jashtë vendit me rezultate të larta.

**Dokumentet e nevojshme për t'u pranuar në konkurrim të jenë origjinale ose kopje të noterizuara si më poshtë:**

- a. Formulari i Aplikimit (shkarkohet nga faqja zyrtare e MD-së),
- b. Curriculum Vitae (CV),
- c. Pasaportë ose kartë identiteti,
- d. Raport mjekësor (i aftë për të punuar),
- e. Diplomë dhe listë notash,
- f. Dëshmi mbi provimin e gjuhës për të cilën konkurron,
- g. Librezë pune,
- h. Referencë/rekomandim nga punëdhënësi i mëparshëm apo aktual,
- i. Dëshmi mbi njohjen e programeve bazë të kompjuterit,
- j. Formulari i vetë deklarimit të gjendjes gjyqësore (shkarkohet nga faqja zyrtare e MD-së),
- k. Fatura bankare e cila vërteton parapagimin e tarifës (shkarkohet nga faqja zyrtare e MD-së).

Tarifa e provimit është në vlerën 5000 (pesëmijë) lekë. Kandidati bën pagesën e shumës përpara postimit të dokumentacionit të aplikimit për llogari të Ministrisë së Drejtësisë, në të gjitha bankat e nivelit të dytë. Një kopje të mandatit të pagesës kandidati ia bashkëlidh dokumentacionit të aplikimit.

Afati i fundit për depozitimin e kërkesave për pjesëmarrjen në provimin e kualifikimit është data **04.12.2017 ora 12.00** në adresën

**PROTOKOLLI I MD-SË**  
**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**  
**MINISTRIA E DREJTËSISË, BLVD. ZOGU I, TIRANË (me postë)**

Lista kualifikuese për të marrë pjesë në konkurrim si dhe lista e të skualifikuarve do të shpallet pranë Ministrisë së Drejtësisë brenda datës **11.12.2017**.

Kandidatët që pretendojnë se plotësojnë kriteret kualifikuese për konkurrim kanë të drejtën e ankimit pranë Komisionit Verifikues në MD jo më vonë se data **14.12.2017** ora **12:00**, duke paraqitur motivet dhe dokumentet përkatëse. Shpallja e kandidatëve të lënë gabimisht jashtë listës kualifikuese për të hyrë në konkurrim bëhet me vendim të arsyetuar nga Komisioni Verifikues në MD brenda datës **15.12.2017**. Lista përfundimtare e kandidatëve të kualifikuar dhe të skualifikuar për konkurrim do të shpallet pranë Ministrisë së Drejtësisë brenda datës **18.12.2017**. Po në këtë datë në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë do të shpallen datat e konkursit. ([www.drejtesia.gov.al](http://www.drejtesia.gov.al))

Çdo aplikim i postuar pas datës së lartpërmendur për pranimin e dokumentacionit të kërkuar nuk do të merret në shqyrtim.